



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-62836
Më 7.4.2015

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 7 prill 2015 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, për lejimin e shpalljes së tenderit për riparcializimin sipas Planit Rregullativ, të “Dardania 2 ”- ZK Lubizhdë e Qytetit dhe ZK Gërnqar, dhe mori këtë:

K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, për lejimin e riparcializimit, sipas Planit Rregullativ, të “Dardania 2 ”- ZK Lubizhdë e Qytetit dhe ZK Gërnqar, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-62836
Më 7.4.2015

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 7 prill 2015 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, për lejimin e shpalljes së tenderit për ndërtimin e një kompleksi kushtuar dëshmorëve të UÇK-së në Gorozhup, dhe mori këtë:

KON KL U Z I O N


Miratohet propozimi i Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, për lejimin e ndërtimit të një kompleksi kushtuar 15 dëshmorëve të UÇK-së të rënë në operacionin “Shigjeta” të Brigadës 128 sulmuese në Pashtrik - Gorozhup, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit.

Ndërtimi i këtij kompleksi do të bëhet në fshatin Gorozhup, në ngastrën kadastrorë 528-0, e evidentuar si Pasuri Shoqërore, KK Prizren.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-62836
Më 7.4.2015

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 7 prill 2015 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, për lejimin e shpalljes së tenderit për hartimin e Planit Rregullativ Urban për Kampusin e Universitetit të Prizrenit, dhe mori këtë:

KON KLUZION

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, për lejimin e hartimit të Planit Rregullativ Urban për Kampusin e Universitetit të Prizrenit, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-62836
Më 7.4.2015

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 7 prill 2015 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejimin e shpalljes së tenderit për ndërtimin e rrugës lokale në lagjen “Petrovë”, dhe mori këtë:

KON KL U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejimin e ndërtimit të rrugës lokale në lagjen “Petrovë” të Prizrenit, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-62836
Më 7.4.2015

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 7 prill 2015 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejimin e shpalljes së tenderit për furnizimin dhe vendosjen e shtyllës te rrethrotullimi në rr. “Wesli Clark” dhe “Ismail Kryeziu” në Prizren, dhe mori këtë:

K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejimin e furnizimit dhe vendosjen e shtyllës në lartësi L-18 m, te rrethrotullimi në rr. “Wesli Clark” dhe “Ismail Kryeziu” në Prizren, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Shtylla do të përdoret për ndriçim publik, për vendosjen e flamujve dhe për vendosjen e kamerave vëzhguese.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-62836
Më 7.4.2015

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 7 prill 2015 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejimin e shpalljes së tenderit për ndërtimin e rrugëve lokale në fshatin Dedaj, dhe mori këtë:

KON KLUZION

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejimin e ndërtimit të rrugëve lokale në fshatin Dedaj, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-62836
Më 7.4.2015

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 7 prill 2015 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, për lejimin e shpalljes së tenderit për furnizim me lëndë djegëse-dru dhe pelet për nevojat e shkollave të Komunës së Prizrenit, dhe mori këtë:

KONKLUZION

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, për lejimin e furnizimit me lëndë djegëse-dru dhe pelet për nevojat e shkollave të Komunës së Prizrenit, për vitin shkollor 2015/2016, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi


Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-62836
Më 7.4.2015

Kryetari i Komunës, pas propozimit të Drejtorisë së Administratës për lejimi e shpalljes së tenderit për organizimin e ekskursionit për nëpunësit civilë të Komunës së Prizrenit në Republikën e Shqipërisë, për nder të Ditës Ndërkombëtare të Punës, mori këtë

KON KL U Z I O N

- I. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Administratës, për lejimin e organizimit të ekskursionit-vizitës tre ditore, për nëpunësit civilë të Komunës së Prizrenit, në Republikën e Shqipërisë, për nder të Ditës Ndërkombëtare të Punës (1 Maji), kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit për mbledhjen e ofertave përkatëse.
- II. Për këtë qëllim, nga buxheti i Komunës - pozicioni i mallrave dhe shërbimeve dhe subvencioneve, lejohen mjetet e nevojshme financiare, ashtu që Komuna e Prizrenit do të participojë me 50 % të shpenzimeve të ekskursionit, ndërsa pjesën tjetër të shpenzimeve prej 50% do ta bartin vetë pjesëmarrësit e këtij udhëtimi, përkatësisht nëpunësit civilë të komunës që udhëtojnë.
- III. Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Administratës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.
- IV. Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Administratës, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, stafi, si dhe Arkivi.
- V. Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja





Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-66495
Më 7.4.2015

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, për përkrahje financiare për OJQ “Hadër”, kryetari i Komunës më 7 prill 2015, miratoi këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, për lejin e mjeteve për përkrahje financiare për OJQ “Hadër” për zhvillimin e aktiviteteve të parapara të kësaj OJQ-je, kështu që, për këtë qëllim, lejohen mjetet financiare në shumën prej 1000 €.
- II. Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe mallrave e shërbimeve i Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.
- III. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.
- IV. Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe arkivi.
- V. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-66486
Më 7.4.2015



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, për përkrahje financiare për OJQ “Handikos”, kryetari i Komunës më 7 prill 2015, miratoi këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, për lejimin e mjeteve për përkrahje financiare për OJQ “Handikos” për zhvillimin e aktiviteteve të parapara të kësaj OJQ-je, kështu që, për këtë qëllim, lejohen mjetet financiare në shumën prej 2000 €.
- II. Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe mallrave e shërbimeve i Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.
- III. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.
- IV. Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe arkivi.
- V. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-66483
Më 7.4.2015




Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, për formimin e komisionit për përzgjedhjen e përfituesve të meremetimit të shtëpive të familjeve skamnore të Komunës së Prizrenit, kryetari i Komunës me 7 prill 2015, mori këtë

AKTVENDIM

- I. Formohet dhe emërohet komisioni për përzgjedhjen e përfituesve të meremetimit të shtëpive të familjeve skamnore të Komunës së Prizrenit.
- II. Për anëtarë të këtij komisioni emërohen:
 - a. Elhame Berisha, drejtoresh e DPMS – kryesuese,
 - b. Ilir Baldedaj, drejtor i DA-së
 - c. Sengjar Karamuqo, drejtori i DGJK, anëtarë.
- III. Detyrat e komisionit do të jenë: pas vlerësimit dhe verifikimit të të gjitha rasteve-kërkesave dhe pas plotësimit të kriterëve që i përcakton ky komision, të bëjnë listën përfundimtare të familjeve që përfitojnë në meremetimin e shtëpive. Lista përfundimtare duhet të jetë në harmoni me planifikimin buxhetor të paraparë për këtë qëllim.
- IV. Komisioni nga pika II e këtij Aktvendimi, detyrat dhe përgjegjësitë e tij do t'i ushtrojë në pajtim me ligjin në fuqi.
- V. Për zbatimin e këtij Aktvendimi do të kujdesen: Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe të emëruarit.
- VI. Me këtë Aktvendim, të njoftohen: Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, të emëruarit dhe Arkivi.
- VII. Ky Aktvendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti


Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-66474
Më 7.4.2015

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, për lejitimin e angazhimit të një (1) psikologu për dhënie të shërbimeve të veçanta në kuadër të projektit të familjeve strehuese, kryetari i Komunës më 7 prill 2015, miratoi këtë:

V E N D I M

- I. Lejohet angazhimi i një (1) psikologu për dhënie të shërbimeve të veçanta në kuadër të projektit të familjeve strehuese familjare në afat të caktuar.
- II. Psikologu i përshkruar si në nenin I të këtij Vendimi, do të angazhohet konformë dispozitave të Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare nr. 02/L-17, Ligjit nr 04/L-081 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-17, drejtorisë përkatëse të Komunës dhe akteve të tjera ligjore që e rregullojnë këtë lëmi.
- III. Në emër të punëve të kryera, personi i angazhuar, do të kompensohet me mjete financiare nga pozicioni mallra dhe shërbime të Drejtorisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale në shumën prej 90 € në muaj.
- IV. Obligohet Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale –QPS, që t'i zhvilloj procedurat e nevojshme ligjore për realizimin e këtij vendimi.
- V. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Zyra e Personelit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.
- VI. Me këtë vendim të njoftohen: Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Zyra e Personelit, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave dhe Arkivi
- VII. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-62836
Më 7.4.2015

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 7 prill 2015 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, për lejimin e shpalljes së tenderit për ndërtimin e Arkives në QPS, dhe mori këtë

KON KLUZION

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, për lejimin e ndërtimit të Arkives në Qendrën për Punë Sociale (aneks i objektit), kështu që për këtë qëllim, lejohet shpallja e tenderit për mbledhjen e ofertave përkatëse.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-66468
Më 7.4.2015

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për lejimin e mjeteve për mbështetje financiare për shënimin e Ditës Ndërkombëtare të Romëve, kryetari i Komunës më 7 prill 2015, miratoi këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, i bazuar në kërkesën e OJQ “Durmish Asllano”, për lejimin e mjeteve për mbështetje financiare për shënimin dhe organizimin e manifestimit Dita Ndërkombëtare e Romëve, që mbahet me 8 prill 2015, kështu që për këtë qëllim lejohen mjetet në shumën 1000 €.
- II. Në kuadër të këtij manifestimi do të realizohet shfaqja teatrale e autorit Fatmir dhe Nexhip Menekshe e quajtur “Bota është Shtet i Romëve”.
- III. Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve i Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit.
- IV. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.
- V. Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.
- VI. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-66460
Më 7.4.2015

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për lejimin e mjeteve për mbështetje financiare për shënimin e festës memoriale-kombëtare të turqve të Kosovës, kryetari i Komunës më 7 prill 2015, miratoi këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, i bazuar në kërkesën e Këshillit Organizativ të FMTK-së, për lejimin e mjeteve për mbështetje financiare për shënimin dhe organizimin e Festës Memoriale-Kombëtare të Turqve të Kosovës, kështu që për këtë qëllim lejohen mjetet në shumën prej 2000 €.
- II. Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.
- III. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.
- IV. Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.
- V. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-66453
Më 7.4.2015

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për lejimin e mjeteve për mbështetje financiare për Klubin e Automobilave “Oldtimer”, kryetari i Komunës, më 7 prill 2015, miratoi këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, bazuar në kërkesën e Klubit të Automobilave “Oldtimer” për lejimin e mjeteve për mbështetje financiare për organizimin e takimeve të 9-ta tradicionale ndërkombëtare të prezantimit të veturave të vjetra -“Oldtimer fest 2015”, që mbahet në Prizren, gjatë muajit maj 2015, kështu që, për këtë qëllim lejohen mjetet financiare në shumën prej 1500 €.
- II. Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.
- III. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.
- IV. Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, KA “Oldtimer”, si dhe arkivi.
- V. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-66446
Më 7.4.2015




Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b dhe d të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, kryetari i Komunës, më 7 prill 2015, miratoi këtë:

V E N D I M

- I. Realizohet Memorandumi i Bashkëpunimit ndërmjet Komitetit Olimpik të Kosovës dhe Komunës së Prizrenit të datës 8.1.2015.
- II. Komuna e Prizrenit, duke u bazuar në nenin 3 të Memorandumit të Bashkëpunimit të cekur në nenin I të këtij Vendimi, lejon mjetet e nevojshme financiare për dy sportistë prizrenas dhe atë për:
 - a. Armend Xhoxhaj –boksier, lejon mjetet në shumën 137 € në muaj dhe
 - b. Kastriot Sedolli – mundës, lejon mjete në shumën 137 € në muaj.
- III. Mbështetja financiare për dy sportistët e lartcekur do të bëhet për 20 muaj me radhë duke filluar nga janari i vitit 2015 deri në korrik 2016 dhe të njëjtat do të alokohen në xhirollogarinë e KOK nr. 1110216078000138 në Pro Credit Bank në Prishtinë në dedikim Armend Xhoxhaj dhe Kastriot Sedolli.
- IV. Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin II dhe III të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe mallra dhe shërbime të Komunës së Prizrenit.
- V. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.
- VI. Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, KOK , të lartcekurit, si dhe arkivi.
- VII. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-66439
Më 7.4.2015

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b dhe d të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Shëndetësisë, kryetari i Komunës, më 7 prill 2015, miratoi këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shëndetësisë, për lejimin e mjeteve për mbështetje financiare për trajtim mjekësor të Cemil Luma, deputet i Kuvendit të Komunës së Prizrenit, kështu që, për këtë qëllim, dhe në emër të mbulimit të pjeshëm të shpenzimeve të mjekimit-trajtimit mjekësor, lejohen mjetet e nevojshme financiare në shumën prej 3000 €.
- II. Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve, mallra dhe shërbime të Komunës së Prizrenit.
- III. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Shëndetësisë dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.
- IV. Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Shëndetësisë, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, Kuvendi i Komunës, i lartcekuri, si dhe arkivi.
- V. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-62836
Më 7.4.2015

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 7 prill 2015 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, për lejin e shpalljes së tenderit për furnizim me lëndë djegëse-thëngjill për nevojat e shkollave të Komunës së Prizrenit, dhe mori këtë:

K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, për lejin e furnizimit me lëndë djegëse-thëngjill për nevojat e shkollave të Komunës së Prizrenit, për vitin shkollor 2015/2016, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja,

